

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Save the Children



05 Janar 2022

THIRRJE PËR PROPOZIME

Referencë 2022/001

**GRANTE TË VOGLA PËR BASHKITË PËR NDËRTIMIN E
KËNDEVE TË LOJËRAVE DHE KOPSHTEVE (BAHÇEVE) NË
DISA SHKOLLA TË PËRZGJEDHURA NË KUADËR TË
PROJEKTIT “SHKOLLAT PËR SHËNDETIN”**

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Përshkrimi i Projektit

“Shkollat për Shëndetin” është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Save the Children. Ky projekt mbarëkombëtar përbëhet nga një Fazë Fillestare 1-vjeçare (Mars 2020 – Shkurt 2021), e ndjekur nga një Fazë Kryesore 4-vjeçare (Mars 2021 – Shkurt 2025).

Qëllimi kryesor i projektit është të zvogëlojë ekspozimin ndaj faktorëve kryesorë të rrezikut për sëmundjet jo të transmetueshme (NCD) në popullatën shqiptare në përgjithësi, me fokus të veçantë tek nxënësit e shkollave. Më konkretisht, “Shkollat për Shëndetin” synon të promovojë ndryshime pozitive në sjellje midis të gjithë nxënësve të shkollave fillore (6-16 vjeç) në Shqipëri, familjeve dhe komuniteteve në përgjithësi.

Përfitues të këtij projekti do të jenë të gjitha shkollat 9-vjeçare në Shqipëri (nëpërmjet ndërhyrjeve online). Për më tepër, një kampion përfaqësues mbarëkombëtar prej 120 shkollash do të përfitojë nga ndërhyrjet shtesë në terren, nëpërmjet një përfshirje graduale të shkollave, duke filluar me 30 shkolla në vitin e parë të Fazës Kryesore (që mbulon periudhën mars 2021 – shkurt 2022) në tre qarqe të Shqipërisë.

1.2. Përshkrimi i Grantit

Një nga rezultatet e projektit konsiston në krijimin e ambjenteve mbështetëse në mjediset e shkollës për të lehtësuar zbatimin e ndërhyrjeve për promovimin e shëndetit, programe dhe aktivitete që nxisin ndryshime pozitive të sjelljes tek nxënësit e shkollës. Në këtë kuadër, projekti synon të mbështesë shkollat e përzgjedhura për ngritjen e kopshteve/baceve shkollore dhe këndeve të lojërave në bashkëpunim me pushtetin vendor duke siguruar edhe angazhimin e sektorit privat.

2. STRUKTURA E ADMINISTRIMIT TË GRANTIT

Administruesi i Grantit. Ky grant ofrohet nga Projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe do të administrohet nga Save the Children.

Grupi i Autorizuar. Për implementimin e Grantit është autorizuar ekipi i projektit “Shkollat për Shëndetin”.

Grupi Vlerësues. Komiteti i Vlerësimit ngrihet nga projekti (nën “Save the Children”) për të vlerësuar dhe përzgjedhur projekt-propozimet. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit në çdo rast duhet të sigurojnë vlerësimin e tyre profesional, të paanshëm dhe konfidencial të projekt propozimeve. Komisioni i Vlerësimit mund të mbështetet edhe në ekspertizën e jashtme teknike të paanshme, nëse gjykohet e arsyeshme.

3. KRITERET E FINANCIMIT

Të gjitha kërkesat për Financim nga Granti duhet të jenë brenda kufirit minimal dhe maksimal të referuar më poshtë:

Fondi limit per nje grant eshte minimumi 5,000 CHF dhe maksimumi 8,000 CHF.

Shuma e përgjithshme treguese e vënë në dispozicion në këtë Thirrje për Propozime është 80,000 CHF pa TVSH. Grant-dhënësi rezervon të drejtën të mos përdorë të gjitha fondet në dispozicion. Projekti synon të akordojë minimalisht 10 grante.

Kostot e pranueshme të projekteve sipas kësaj thirrjeje do të mbulohen 80% dhe pjesa tjetër prej 20% duhet të mbulohet nga Bashkitë. TVSH-ja duhet të jetë e përfshirë në ofertën e dërguar dhe projekti nuk nje kosto apo detyrime të tjera shtesë përveç grantit të vënë në dispozicion.

Në rastet kur një aplikant aplikon për grant për të financuar një projekt me vlerë më të lartë se shuma maksimale e referuar më sipër, përqindja e kostove të projektit të mbuluar nga granti do të llogaritet në bazë të shumës së kostos totale të pranueshme të projektit.

Projekti mund të pranojë financimin e disa projekteve brenda të njëjtës Bashki, por kostot e prezantuara në Projekt Propozim duhet të jenë të ndara dhe cilësuara për secilën shkollë ku do të zbatohet projekti.

4. APLIKANTËT E MUNDSHËM

Aplikuesi Kryesor

Në mënyrë që të kualifikohet për financim, aplikanti kryesor duhet:

- Të jetë një nga bashkitë e Shqipërisë në qarqet (Elbasan, Korçë dhe Kukës), sipas Tabelës 1, më poshtë.
- Shkolla ku do të zbatohet projekti të jetë brenda territorit gjeografik që administron.
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e operacioneve për zbatimin e projektit në shkollat brenda rajonit gjeografik që mbulon. Kjo nuk kufizon mundësinë apo nevojën për kontraktimin e një eksperti, subjekti tjetër privat apo Organizmi të shoqërisë civile për zbatimin e një apo disa proceseve gjatë zbatimit të projektit.

Qarku	Bashkia
Qarku i Elbasanit	Bashkia Belsh Bashkia Cërrik Bashkia Elbasan Bashkia Gramsh Bashkia Librazhd Bashkia Peqin Bashkia Prrenjas
Qarku i Korçës	Bashkia Devoll Bashkia Kolonjë Bashkia Korçë Bashkia Maliq Bashkia Pogradec Bashkia Pustec
Qarku i Kukësit	Bashkia Has Bashkia Kukës Bashkia Tropojë

Tabela 1. Lista e Bashkive të kualifikuara për aplikim (sipas Qarqeve)

- Nëse nuk ka bashkë-aplikues, atëherë aplikanti kryesor do të përcaktohet si përfitues në kontratën e grantit.
- Në rastin e bashkë-aplikuesve, këta do të quhen partner(ë) pas dhënies së grantit, ndërsa përfituesi (aplikuesi kryesor) do të identifikohet në kontratën e grantit si Koordinator.

-
- Aplikanti kryesor do të menaxhojë fondet e grantit dhe do t'i transferojë fondet te çdo bashkë-aplikues, nëse ka, në përputhje me aktivitetet dhe kostot e parashikuara.

Bashkë-aplikimet

Aplikantët mund të aplikojnë individualisht ose në grup, nëse specifikohet qartë roli i secilës palë në zbatimin e projektit për ndërtimin e këndeve të lojërave dhe kopshteve. Në secilin rast Bashkia e cila ka në administrim pronën e shkollës ku do të zbatohet projekti, do të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të jetë një nga bashkitë e Shqipërisë në qarqet (Elbasan, Korçë dhe Kukës), sipas Tabelës 1, më sipër.
- Shkolla ku do të zbatohet projekti të jetë brenda territorit gjografik që administron.
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e operacioneve për zbatimin e projektit në shkollat brenda rajonit gjeografik që mbulon. Kjo nuk kufizon mundësinë apo nevojën për kontraktimin e një eksperti, subjekti tjetër privat apo Organizmi të shoqërisë civile për zbatimin e një apo disa proceseve gjatë zbatimit të projektit.
- Zbatimi i projektit mund të jete nga minimumi 2 muaj ne maksimumin 4 muaj. Çdo propozim jashte ketyre afateve nuk do konsiderohet.

5. REZULTATET E PRITSHME NGA APLIKUESIT

Përgjegjësitë e aplikantëve në procesin e aplikimit:

- Përgatisin projekt propozimin në përputhje me formularin e aplikimit¹ të shpërndarë nga “Shkollat për Shëndetin”, duke respektuar afatet e aplikimit.
- Detajimi i kontributit vendor financiar prej të paktën 20% të shumës së projektit (mbulimi i taksave vendore apo aplikimeve te ndryshme prane bashkise, trualli, etj.).

Përgjegjësitë në zbatim:

- Bashkia e kualifikuar që të përftojë financim të projekteve do të jetë institucioni direkt përgjegjës për zbatimin e projektit, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në marrëveshjen e projektit.
- Bashkitë do të jenë përgjegjëse për organizmin e procesit të prokurimit në përputhje me Ligjin Shqiptar, nëse propozimi përfshin furnizime në materiale dhe shërbime nga sektori privat, etj.

¹ Shih Shtojca 1 “Formulari i aplikimit”

-
- Bashkitë do të jenë përgjegjëse për përgatitjen e projekt propozimeve, bazuar në projekte teknike/plane si dhe për caktimin e supervisorëve që do të ndjekin zbatimin e kontratave të punimeve.
 - Përgatitja e të gjitha lejeve, licencave të kërkuara nga Ligji Shqiptar përsa i përket përgatitjes së zbatimit të projektit.

6. VLERËSIMET E APLIKIMEVE

Vlerësimi i aplikimeve të marra do të kalojë në katër faza:

Faza 1. Analizimi vlefshmërisë së aplikimeve (screening).

Kjo fazë do të përfshijë verifikimin e kualifikimit të aplikantëve, Projekt Propozimi (qasja dhe kohëzgjatja) dhe kosto financiare (duke përfshirë kategoritë e kostove të prezantuara dhe shumën maksimale të kërkuar). Vetimi i aplikuesëve sipas rregullave të zbatuesit Save the Children.

Faza 2. Vlerësimi dhe përzgjedhja e propozimeve

Propozimet e marra do të vlerësohen përputhje me sistemin e përcaktuar të vlerësimit të vlerësimit me pikë të paraqitur më poshtë. Në total vlerësimi do të ketë 100 pikë të cilat do të shpërndahen sipas kategorive të vlerësimit.

Aplikantët kryesorë do të informohen me shkrim për vendimin në lidhje me aplikimin e tyre dhe nëse aplikimi i tyre është refuzuar, do të komunikohen edhe arsyet e vendimit negativ. Vendimi përfshin gjithashtu listën e dokumenteve mbështetëse që do të duhet të sigurohen për qëllimin e nënshkrimit të kontratës së grantit (kur aplikimi është pranuar), dhe afati i fundit për të siguruar këto dokumente. Mosdorëzimi i dokumenteve të kërkuara mbështetëse brenda afatit mund të çojë në refuzimin e aplikimit.

Çdo aplikim i refuzuar do të zëvendësohet nga aplikimi tjetër i renditur më mirë në listën rezervë.

Kriteret e vlerësimit fokusohen si në kapacitetin operacional dhe financiar të aplikantit(ve) dhe në cilësinë e aplikimeve për sa i përket rëndësisë së veprimit, konsistencës së tij me objektivat e thirrjes për propozime, cilësinë, ndikimin e pritur, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin në arritjen e rezultateve të pritshme.

Pikëzimi:

Sistemi i vlerësimit është i ndarë në seksione dhe nënseksione. Çdo nënseksion do t'i jepet një pikë ndërmjet 1 dhe 5 si më poshtë: 1 = *Shumë Dobët*; 2 = *Dobët*; 3 = *Pranueshëm*; 4 = *Mirë*; 5 = *Shumë Mirë*.

Aktiviteti	Pikët Maximale	1	2	3	4	5
1. Kapacitetet financiare dhe menaxhuese të Bashkisë aplikuese	25					
1.1 Oferta Financiare	20					
1.2 Përvoja në menaxhimin e projekteve të ngjashme	5					
2. Cilësitë teknike të projekt-propozimeve dhe Pëputhshmëria e Propozimit	35					
2.1. Sa relevant është propozimi me pritshmëritë e thirrjes?	15					
2.2. Cilësitë e dokumentacionit mbështetës.	10					
2.3. Buxheti edhe efektiviteti i kostos	10					
3. Qëndrueshmëria e projektit	15					
4. Aspekte të vlerës së shtuar që sjell projekt-propozimi	25					
4.1 Angazhimi i Donatorëve të tjerë në projekt	10					
4.2 Angazhimi i sektorit privat që operon lokalisht	5					
4.3 Përfshirja e Subjekteve të shoqërisë Civile dhe figurave kyçe lokale në projekt	10					

INFORMACION TË SHITESË PËR APLIKIMET

Pyetjet për detaje, sqarime dhe mbështetje në plotësimin e aplikimeve, mund të dërgohen me e-mail jo më vonë se 5 ditë pune para afatit të fundit për dorëzimin e tyre, në adresën e mëposhtme, duke treguar qartë referencën e thirrjes për propozime 'Call for Proposal No. 2022/001:

Adresa e e-mailit: shkollat.per.shendetin@savethechildren.org

Autoriteti kontraktor nuk ka asnjë detyrim për të dhënë sqarime për pyetjet e marra pas kësaj date.

Për të siguruar trajtim të barabartë të aplikantëve, Publikuesi i Thirrjes nuk do t'u japë sqarime individuale aplikantëve mbi përshtatshmërinë e aplikantëve kryesorë, bashkë-aplikuesit ose aktivitete specifike.

Si aplikohet?

Aplikimi që të konsiderohet i plotë duhet të përfshijë:

a) Një original i dokumenteve të aplikimit:

Shtojca 1 - Formulari i Aplikimit për Projektin duke përfshirë planin e punimeve dhe cdo dokumentacion ku janë kushtet teknike të projektit dhe paisjeve që do përdoren në zbatimin e projektit.

Shtojca 2 – Buxheti i detajuar (skedari Excel)

Të dhënat bankare të aplikuesit kryesor (Vërtetim bankar ku specifikohet numri i IBANit)

Aneksi I – Deklarata e Vettingut”

ANEKSI II – Lista kontrolluese për aplikantët

Për bashkaplikuesit duhet një marrëveshje bashkpunimi midis palëve.

b) Një USB që duhet të përmbajë saktësisht të njëjtin aplikacion si versioni letre i bashkangjitur.

Aplikimet duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur me postë kombëtare që tregon vulën e lexueshme, shërbimin privat të korrierit ose me dorëzim (një certifikatë pranimit e nënshkruar dhe e datës do t'i jepet dorëzuesit) në adresën e mëposhtme:

Titulli i Aplikimit ku përfshihet referenca e thirrjes.

Adresa

Save the Children

Rruga Mihal Popi (Ish Pallatet 1 Maji)

Ndërtesa 7 (Vila Lami), Kodi Postar 1021,

Kutia Postare 8185

Tiranë – Shqipëri

Afati i aplikimit

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data **31 Janar 2022** siç dëshmohet nga data e dërgimit, vula e postës ose data e fletë depozitimit. Në rastin e dërgesave me dorë, afati i fundit për pranim është ora 14:00 me orën lokale, siç dëshmohet nga akti i dorëzimit. Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit do të refuzohet automatikisht.

Shtojca 1: Formulari i Aplikimit**1. Të dhëna të përgjithshme**

Aplikanti:	
Personi/at e kontaktit:	
Titulli i projektit	
Vendndodhja	
Buxheti i kërkuar për mbështetje nga granti	
Data e dorëzimit <i>(plotësohet nga stafi i "Shkollat për Shëndetin")</i>	
Numri i projektit: <i>(plotësohet nga stafi i "Shkollat për Shëndetin")</i>	

2. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës duke shpjeguar nevojën për këtë projekt. (jo më tepër se 1 fq.)

3. Përshkrimi i projektit (jo më tepër se 1 fq.)

3.1 Titulli i projektit
3.2 Qëllimi i projektit
3.3 Objektivi/at specifikë të projektit
3.4 Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit
3.5 Aktivitetet e projektit. Listoni aktivitetet kryesore dhe kohëzgjatjen e tyre.

3.6 Kostoja e projektit (në Lekë)

<i>Vlera totale e projektit</i>	
<i>Buxheti i kërkuar nga Granti</i>	
<i>Buxheti i kontribuar nga Bashkia (reflektoni mënyrën e kontributit të Fondit kriter kualifikues prej min 20% të buxhetit total)</i>	
<i>Buxheti i Premtuar nga Donatorë të tjerë apo Burime të tjera financimi (nëse ka konsiderohet vlerë shtesë për aplikimin)</i>	

Ju lutem përshkruani si e keni llogaritur koston e projektit.

4. Grupet e synuar dhe përfituesit (jo më tepër se 0.5 fq.)

5. Informacion tjetër (jo më tepër se 0,5 fq.)

Bashkangjitur këtij dokumenti do të gjeni:

1. Konfirmimin që Bashkia do të bashkëfinancojë projektin me të paktën 20% të shumës totale të projektit (duke specifikuar zërat ku kontribuon dhe vlerat respektivë, në rast se kontributi nuk është financiar).
2. Kontratat e financimit nga donatorë Lokalë dhe vlerat (nëse ka).
3. Vërtetimin se Shkolla dhe mjedisi ku do të zbatohet projekti është pronë e Bashkisë.
4. _____
5. _____

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të Bashkisë

ANEKSI I – DEKLARATA E VETTING-ut

(Ky seksion duhet të plotësohet nga çdo aplikant)

Emri i plotë i Organizatës	
Data e regjistrimit	
Vendi i regjistrimit	
Adresa zyrtare e regjistrimit	
Faqja e internetit dhe adresa e postës elektronike të Organizatës nëse është e aplikueshme	

Numri i telefonit: Kodi i shtetit + kodi i qytetit + numri	
Numri i faksit: Kodi i shtetit + kodi i qytetit + numri	
Emrat e plotë të stafit kryesor (Bordi i Drejtorëve dhe/ose Drejtori i Shtetit, duke përfshirë datën/vitin/vendlindjen e tyre	

Aplikanti deklaron se nuk është në asnjë nga situatat që e përjashton atë nga pjesëmarrja në kontrata. Për më tepër, pranohet dhe pranohet që nëse aplikanti merr pjesë, pavarësisht se është në ndonjë nga këto situata, ai mund të përjashtohet nga procedurat e tjera

Emri:	
Organizata:	
Pozicioni:	
Nënshkrimi:	
Data dhe vendi:	

ANEKSI II – LISTA KONTROLLUESE PËR APLIKANTËT

Titulli i Propozimit:	Shkruani një nga artikujt më poshtë	
	Po	Jo
Pjesa A (administrative)		
1. Është përdorur formulari i saktë i aplikimit për grant.		
2. Është përfshirë plani I punimeve		
3. Buxheti paraqitet në excel dhe në Lekë		
4. Përfshihet një kopje origjinale (e nënshkruar) e dokumenteve 1, 2, 3 dhe 6		
5. Një version elektronik i propozimit (USB) është bashkangjitur		

6. Deklarata e Vettingut është plotësuar dhe nënshkruar.		
7. Një dokument i lëshuar nga Departamenti i Tatimeve që vërteton se organizata nuk ka detyrime financiare në pritje, si detyrime sociale, shëndetësore ose tatimore - lëshuar brenda periudhës së thirrjes.		
8. Dëshmi bankare (Vërtetim bankar) me llogarinë bankare, dhe IBAN në emër të aplikantit kryesor -		
9. Nëse ka bashkëpunues organizata apo Kompani duhet një CV e organizatës/kompanisë, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i saj, duke përfshirë të gjitha projektet e kaluara dhe aktuale (burimi i financimit dhe kontaktet, afati kohor, rajoni i mbulimit dhe partneritetet); Ekstrakti i gjykatës si dhe dokumentat e kërkuara në pikën 6 dhe 7.		
Pjesa B (përshtatshmëria) (Nëse ndonjë nga përgjigjet e mëposhtme është JO, aplikacioni refuzohet dhe nuk ka nevojë për analiza të mëtejshme. Zarfi arkivohet për regjistrim)		
1. Shuma e kërkuar është brenda minimumit dhe maksimal të lejuar nga thirrja për propozim		
2. Kohëzgjatja e aksionit është brenda kufijve të thirrjes për propozim.		
3. Aksioni do të zbatohet në një qark të Shqipërisë të përmendur mësipër.		